



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 15.04.2025		
Prilbjen:		
Njesia Jednica	Nr. Seri	Shtesa Dodatak
08-463/02-18750		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK - KONJUH

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-462/01-4912, të dates 28.01.2025, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-4914, të dates 28.01.2025, për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit shpallë këtë:

NJOFTIM

PËR ANULIMIN E NJOFTIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Nr. 08-462/01-11780 TË DATËS 17.03.2025

- I. **NJOFTOHEN** të gjithë aplikuesit për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale me nr. të parcelës P-71409036-00166-7 dhe P-71409036-00164-20 ZK – Konjuh, se procesi i vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit publik Nr. 08-462/01-11780 të datës 17.03.2025 ANULOHEM për shkak të gabimeve në përmbajtjen e kërkesave të Njoftimit publik.
- II. Puna e Komisionit sipas Njoftimit publik me Nr. 08-462/01-11780 të datës 17.03.2025 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ZK – Konjuh përfundon, prandaj edhe anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra përkitazi me këtë Njoftim publik.
- III. Ky Njoftim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni Vlerësues.

A r s y e t i m

Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-71409036-00166-7 dhe P-71409036-00164-20 ZK – Konjuh, i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-4914 të dates 28.01.2025, gjatë punës së tij ka analizuar në hollësi dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit dhe me këtë rast ka kostatuar se:


J.S. L.R. AG L.B. B.4

Në pikën III "Dokumentet e kërkuara" nr. rendor 7 të Njoftimit publik, kërkesa e përcaktuar ishte përkufizuar në mënyrë të gabueshme, përkatësisht nuk kishte mbështetje ligjore. Me ndryshimet e fundit ligjore është ndryshuar rregullativa për lëshimin e dëshmive për të konstatuar faktin e ndodhjes nën hetime të një subjekti apo të zhvillimit të procedurës penale ndaj tyre. Për këtë shkak, ofertuesit janë ndodhur në pamundësi për të siguruar dokumentet përkatëse.

Palët e pakënaqura nga procesi i shqyrtimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimi të Njoftimit kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditëve kalendarike në Komisionin e ankesave.

Ky Njoftim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komunës dhe me të njëjtin njoftohen ofertuesit të cilët kanë parashtruar ofertat në bazë të Njoftimit publik Nr. 08-462/01-11780 të datës 17.03.2025.

Nr: _____
Datë: 15.05.2025

1. Imri Semetishti 
2. Latif Ramadani 
3. Albiona Tasholli 
4. Lulzim Rrustemi 
5. Bekim Krasniqi 